V E N D I M
Nr.489, datë 21.10.1999

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 1999 PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Agjencisë Kombëtare të Energjisë, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, në zërin shpenzime për paga, i shtohen 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.
2. Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në buxhetin e vitit 1999 në zërin shpenzime për paga, i pakësohen 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.
3. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko